



## ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt.27.10.2020 nga Operatori Ekonomik "GAFA CONSTRUCTION" SHPK Shtime, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "Ndërtimi i ndriçimit publik në disa rrugë të qytetit dhe në fshatrat Dumnicë e Poshtme, Letanc dhe Obranc" me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-20-6213-5-2-1, nxjerrë këtë:

### VENDIM

Aprovohet kërkesa për rishqyrtim e dt. 27.10.2020, lidhur me ankesën parashtruar nga OE "GAFA CONSTRUCTION" SHPK Shtime, në aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i ndriçimit publik në disa rrugë të qytetit dhe në fshatrat Dumnicë e Poshtme, Letanc dhe Obranc" me nr. të Prokurimit: 615-20-6213-5-2-1, nr.Brendshëm 615-20-117-5-2-1

- Aktiviteti i prokurimit është pezulluar dhe kthehet në rishqyrtim

### Arsyetim

AK, Komuna e Podujevës pas shqyrtimit të kërkesës së OE."GAFA CONSTRUCTION" SHPK. Shtime, parashtruar kërkesën duke kërkuar nga AK - Komuna e Podujevës që ta aprovoj kërkesën për rishqyrtim dhe të kthej përgjegje në pyetje e parashtruara për sqarime, të mundësoj marrjen e informacioneve të kërkuara dhe të jetë kohë e mjaftueshme për pregaditjen e ofertës teknike dhe financiare. AK ka pezulluar aktivitetin e prokurimit dhe ka marr vendim që kërkesa për Rishqyrtim e OE të cekur më lartë të aprovohet duke iu referuar kërkesës për rishqyrtim.

AK, Komuna e Podujevës ka analizuar kërkesën për rishqyrtim parashtruar në fazën e tenderimit duke ju referuar disa pyetjeve për tu sqaruar dhe vlerëson që aktiviteti i cekur i prokurimit të kthehet në rishqyrtim.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092,vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në OSHP.

Nr.14-020/05-0065936/20  
Podujevë,  
30.10.2020



Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit  
Rasim Fejza